



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga  
“Dhori Tanaka”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
Punë ndërtimore - 45

**VLERA E FONDIT LIMIT: 13,462,585.5 (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë  
e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë pa TVSH nga te Ardhurat Lokale  
2023.**

Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,462,585.5 (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë pa TVSH.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale ,në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

---

**Fondi limit = 13,462,585.5 (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë.**

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjore nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetimi lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësaj, prandaj bashkëve të operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$13,462,585.5 \times 50\% = 6,731,292.75 \text{ Leke}$$

$$13,462,585.5 \times 2 = 26,925,171 \text{ Leke}$$

---

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime germimi ne toke "Kategoria A".
- b. NP-4: Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale "Kategoria A".
- c. NP-7: Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje "Kategoria A".
- d. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve. "Kategoria A".
- e. NS-18: Punime topogjeodezike. "Kategoria A".

Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

➤ **NP-1: Punime germimi ne toke "Kategoria A"**

*Konsiderohen gërmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

➤ **NP-4: Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale "Kategoria A"**

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.*

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.*

➤ **NP-7: Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje "Kategoria A".**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

➤ **NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve "Kategoria A"**

*Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.*

➤ **NS-18: Punime topogjeodezike.**

**“Kategoria A”**

*Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse		Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi ne toke	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	Kategoria A	
		3.47/1b	Mbushje gropash, rrafshim, ngjeshje me tokmak , toke e zak		
		An	Heqje shtrese me rere bituminoze t=10cm		
		2.37/4a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 4.0 km		
NP-4	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	An	Mbushje me cakell t=10cm	Kategoria A	
		3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm		
		3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave, t=5cm,me makineri		
		3.224/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri		
		3.212/b	Bankine, Shtrese stabilizant t=10cm		

NP-7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	3.25/a	Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi $b < 1$ m, $h=1.5$ m, toke e zak.		
		3.25/b	Germim dheu per puseta		
		2.576	Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m		
		3.652	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm		
		3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm		
		3.An/2t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm		
		3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm		
		2.261	Mbulim tubi me rere		
		3.353	Mbushje me material te selektuar nga germimi		
NS-18	Punime topogjeodezik e	Te gjitha kategorite e mesiperme		Kategoria A	

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhier hidroteknik 1 (nje)
- c. Inxhiner gjeodet 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.4.** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** per kete duhet te paraqes diplomë, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- b. **Karpentiere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- c. **Pllaka shtrues 3 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- d. **Specialist per shtresa rrugore 1(nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- e. **Puntore te thjeshte 9 (nente)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- f. **Hidraulik 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) si dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim.
- g. **Shofere 3 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim. ( Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- h. **Manovratore 3 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2022 e ne vazhdim. ( Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi



- Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

.....

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri topograf (gjeodet)** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave te projektit object prokurimi për realizmin e sakte te kuotave dhe shtresave te rruges, kuotave te nenshtresave te rruges , dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit te ujrave te shiut ne trupin ose ne anet e rruges. Është përgjegjës për zbatimin e saktë të piketimit te objektit qe prokurohet, zbërthimin e permasave te projektit konstruktiv dhe arkitektonik, punimet topografike te kuotave te objektit ekzistues dhe atij qe do te ndertohej.etj. Ai është përgjegjës për nivelin (kuoten) dhe permasat e elementeve te objektit etj.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike te objektit qe prokurohet, zbërthimin e projektit , për sistemin hidrik te rrjedhes se ujit ne tubacionet e furnizimit me uje dhe ne tuabcionet e ujrave te bardha dhe te zeza qe do te vendosen ne objekt si dhe lidhjen e tyre me rrjetin ekzistues apo te ardhshem.
- **Teknike ndertimi** ( ose ing ndertimi ne zbatim) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve ne kantierin e projektit object prokurimi për realizmin e sakte te kuotave dhe shtresave te rruges, kuotave te nenshtresave, dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit te ujrave te shiut ne trupin ose ne anet e rruges.
- **Karpiere** eshte pergjegjes per pergatijen e armatures se derrases dhe betonimin e sakte te strukturave beton dhe beton arme te perfshira ne objektin qe prokurohet
- **Pllaka shtruesi** eshte pergjegjes per vendosjen e sakte te bordurave te parapergatitura apo te derdhura ne vend, per shtrimin e sakte te pllakave te parapergatitura per trotuaret e perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Specialist per shtresat rrugore** eshte pergjegjes per ndertimin e sakte te shtresave asfaltike (te ndertuara me binder dhe/ose asfaltobeton) dhe nenshtresave rrugore (te ndertuara me material guri natyror dhe/ose te parapergatitur) te perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Hidraulik** jane personat pergjegjes pergjegjes per montimin e linjave hiraulike ne objekt.

- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit dispononohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.
- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive dhe pajijeve te ndertimit ne kantiar dhe jashte kantierit per kryerjen e proceseve te caktuara te puneve ( psh. presa/pompa betoni,ekskavatore germim, mini fadroma, skre te llojeve te ndryshme etj) te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit dispononohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 27 (njetzet e shtate) persona**.

Periodha për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:***

- |                                       |                  |
|---------------------------------------|------------------|
| • <b>Teknike ndertimi</b>             | <b>1 (nje)</b>   |
| • <b>Karpenriere</b>                  | <b>2 (dy)</b>    |
| • <b>Pllaka Shtrues</b>               | <b>3 (tre)</b>   |
| • <b>Specialist shtresash rrugore</b> | <b>1 (nje)</b>   |
| • <b>Puntore te thjeshte</b>          | <b>9 (nente)</b> |
| • <b>Hidraulik</b>                    | <b>2 (dy)</b>    |
| • <b>Shofere</b>                      | <b>3 (tre)</b>   |
| • <b>Manovratore</b>                  | <b>3 (tre)</b>   |
| • <b>Drejtues Teknik</b>              | <b>3 (tre)</b>   |

***TOTALI = 27 Persona ne Staf (njetzet e shtate).***

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Shënim: Argumentimi mbi numrin e punonjesve.**

Ne objektin “Rikonstruksion dhe adaptim I kopshtit Verbas ne qender ambulatorore” proceset e punes klasifikohen ne keto kategori:

**a) Punime per mobilizimin e kantierit**

Ne keto punime perfishihet pergatitja e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do t percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te stukturohet organika e njerezve qe do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i kantierit me hyrje-daljet e tij. Afati i parashikuar 6 dite pune. Puntore te angazhuar: 1 specialist dhe 2 puntore. Makineri Kamiocine dhe/ose pick-up.

**b) Punime Germimi**

- **Volumi I punimeve** **>1150 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **844 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **1.3625 m2/op**

Keto punime perfishijne punimet per germimin e trasese se objektit dhe heqjen e te gjitha shtresave dhe nenshtresave ekzistuese deri ne kuten e dhene ne projekt. Ne kete kategori punimesh perfishihet germimi i trasese ekzistuese edhe ngarkimi i te gjitha materialeve inerte te dala gjate germimit dhe transporti i tyre per ne vendgrumbullimin e mbetjeve inerte. Për afat e kerkuar te punimeve prej 18 dite pune duhet qe kapaciteti teknik duhet të jetë 4 here me i larte kapacitetit nominal. Kërkesa per mjete pune 2 matrapike, 2 kamione, 1 ekskavator, 1 kamiocine, 1 gjenerator, 1 depozite uji.. Gjithesej puntore te angazhuar: 1 specialiste dhe 3 puntore.

**c) Punime kanalizimi**

- **Volumi I punimeve** **1536 ml.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **12'290 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.125 ml/op**

Keto punime perfishijne ndertimin e mureve te reja sipas percaktimeve ne projekt. Orari nominal mesatar per punimet ne trupin e ruges eshte rreth 8.001 ore/ml. Referuar grafikut qe parashikon afatin 36 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 10 here me shume, ose 5specialiste dhe 5 punetore. Makinerite qe nevojiten jane: 1 Ekskavator, 1 kamion, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 gjenerator, 1 depozite uji.

**d) Punime betoni e b/a**

- **Volumi I punimeve** **107 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **2020 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.053 m3/op**

Keto punime perfishijne punimet e betonit e b/a , ndertrimin e kunetave b/a etj. Orari nominal mesatar per punimet ne trupin e ruges eshte rreth 18.878 ore/m3. Referuar grafikut qe parashikon afatin 20 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 10 here me shume, ose 5specialiste dhe 5 punetore. Makinerite qe nevojiten jane: 1 betoniere, 1 vibrator betoni, 2 trako, 2 karro dore, 1 kamiocine, 1 pompe llaci, 1 gjenerator, 1 depozite uji, skela inventari 150 m2.

**e) Punime per asfaltimin e rruges**

- **Volumi I punimeve** **2652 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **1080 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **2.4555 m2/op.**

Keto punime perfshijne sistemimin e shtresave dhe nenshtresave te rruges. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 6 dite pune, orari mesatar i punimeve 0.925 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimeve ne afatin e parashikuar nevojiten 3 specialiste dhe 4 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 asfaltoshtruese, 1 bitumatrice, 1 karro dore, 1 kamioncine, 1 gjenerator, 1 depozite uji.

**f) Punime per demobilizimin e kantierit**

Per demobilizimin e kantierit duke qene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (minikantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

**Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:**

**Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialitetev ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.**

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- |   |      |         |
|---|------|---------|
| • Kamion me aftesi mbajtese mbi/ose 10 ton    | cope | 2 (dy)  |
| • Kamioncine me aftesi mbajtese deri ne 3 ton | cope | 1 (nje) |
| • Kamion me vinc                              | cope | 1 (nje) |
| • Ekskavator me zinxhire 0.5 m3               | cope | 1 (nje) |
| • Rul   | cope | 1 (nje) |
| • Depozite uji >1000 litra                    | cope | 1 (nje) |
| • Betoniere                                   | cope | 2 (dy)  |
| • Autobitumatrice                             | cope | 1 (nje) |
| • Asfalto shtruese                            | cope | 1 (nje) |
| • Mini Fadrome                                | cope | 1 (nje) |
| • Vibrator betoni thellesie                   | cope | 2 (dy)  |
| • Matrapik                                    | cope | 1 (nje) |
| • Gjenerator                                  | cope | 1 (nje) |

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.

*Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.*

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që këto mjete nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi (pikat 2.3.3-2.3.7):** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetëve të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

### **2.3.8. Mbështetur në:**

*Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE*

*Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve*

*Neni 12 Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve te ndertimit*

*Neni 24/1*

*Neni 25 Lejet mjedisore.*

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Per kriterin e vendosur te kerkeses per license QKB , III.2.B , argumentojme , qe ne baze te legjislacionit shqiptar, cdo operator ekonomik qe ushtron veprimtari ne nje territor te caktuar, duhet te hape edhe nje seli te saj , NIPT si dhe te ushtroj aktivitetin e plote si subjekt ekonomik. Mbështetur ne Ligjin per lejet e mjedisit si dhe VKM 419 “ Mbi procedurat e pajisjes me leje mbjedisi per ushtrimin e aktivitetit” , Subjekti qe do te kryeje punimet, klasifikohet ne operator qe gjeneron mbetje urbane ne ate njesi administrative ku do te kryeje punime. Per rrjedhoje , cdo subjekt duhet te jete i pajisur me lejen perkatese te mjedisit , ku detyrimisht percaktohen format, detyrat dhe metodat te trajtimit te mbetjeve te gjeneruara, si dhe metodat e trajtimit dhe rekuperimit te nderhyrjeve. Ne kete rast bashkia eshte partneri dhe bashkepuntori qe ben te mundur trajtimin me efikas te mbetjeve, por theksojme se , nga pikepamja ligjore, eshte operatori, ai qe ben gjenerimin e mbetjeve dhe per rrjedhoje edhe ka edhe detyrimin ligjor te trajtoje keto mbetje.

[Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim](#)

### **2.3.9: Certifikat ISO:**

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentimi:** *Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

**b) ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme),** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentimi:** *Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

**c) ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme),** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentimi:** *Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre. Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e*

*punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbeshtetje të natyrës së objektit të prokurimit.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike.**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se një nga zërat e preventivit është e shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.**

Specifikimet teknike janë bërë për përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe janë hartuar për çdo zë punimi sipas preventivit të punimeve, bashkelidhur dokumentave të tenderit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 03/03/2023, ora 11:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka”.**



NJESIA E PROKURIMIT

Daniela Kukaj

Arben Manoku

Mitjon Nikolla